

STATUT

I SHOQERISE "IMMOMATUTIS - LEO " SHPK

Me cilesine e "ortakut themelues " :

Siegfried Matutis, i datelindjes 30 Mars 1961, i lindur ne Altotting-Gjermani dhe banues ne Gjermani, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar,identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjofitim C9TPFH5T2, leshuar me date 08 Tetor 2018, dhe **Enkelea Rodhaj** identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjofitim ID H21109058U, leshuar nga MB Tirane me date 20 SHKURT 2020 e cilet me cilesine e " Ortakut Themelues ", me kerkuan redaktimin e ketij statuti, nepemjet te cilit deklarojne se me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**IMMOMATUTIS - LEO** " shpk.

KREU I

Krijimi,Personaliteti juridik,Selia

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "**IMMOMATUTIS - LEO** " shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit , në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "**IMMOMATUTIS - LEO** " shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbjet vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne adresen: Lagjia 1, Bashkia Sarande- Rruga Butrinti,Godina Nr.38.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- Shitblerje pasurish te patundshme,interior disaiwer, mirembajtje dhe sistemime,punime te brendshme,dhenie me qera de administrim banesash..

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar , duke filluar nga data e regjistrimit ne Regjistrin Tregtar Shqiptar.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë.

Ky kapital perbehet nga kontributet:

Z. **Siegfried Matutis** kontribon me shumen 50.000 leke.

Znj. **Enkelea Rodhaj** kontribon me shumen 50.000 leke.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare në 2 pjesë.

Ne baze te kontributeve te mesiperme:

Z. **Siegfried Matutis** merr 1 pjese te kapitalit themeltar me vlere 50.000(pesedhjetemijemije)leke.

Z. **Enkelea Rodhaj** merr 1 pjese te kapitalit themeltar me vlere 50.000(pesedhjetemijemije)leke.

Te gjitha pjeset e kapitalit themeltar jane nenshkruar,shlyer plotesisht dhe jane shperndare ndermjet ortakeve si me lart.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.


Ortakët pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.



KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
Asambleja e ortakeve brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakeve.
Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10

Administrimi


Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem.
Administrator i pare i shoqerise eshte emeruar **Znj.Verena Matutis**, me nje afat pese vjeçar me te drejte rimerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e ortakeve te shoqerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asambleja e ortakeve.
Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.
Administratorit ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.



Neni 12

Përgjegjësia

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Ortakët kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese së ortakeve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblese së ortakeve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jënë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e Asamblese së ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë Asamblese së ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Bilanci Kontabel vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga Asambleja e ortakeve, e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

Neni 17

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve te të shoqerise.

Neni 18

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene :

a. Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b. Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji " Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

c. Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 19

Bashkimi dhe ndarja

Shoqëria, me anë të bashkimit, mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ajo themelon.

Shoqëria gjithashtu me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.

Ortakët e shoqërise, në kuadrin e operacioneve të përmendura me lart përfitojne pjesë të kapitalit themeltar nga shoqëria ose shoqëritë përfituese dhe sipas rastit një kompensim me para, vlera e të cilit nuk mund të kalojë 10 për qind të vlerës nominale të pjesëve të kapitalit themeltar të dhëna.

Operacionet e përmendura me lart mund të realizohen ndërmjet shoqërive të formave të ndryshme.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim të shoqërise që zhduket, dhe kalimin e plotë të trashëgimisë së saj te shoqëritë përfituese, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njëkohësisht për ortakët e shoqërive që zhduken marrjen e cilësisë së ortakëve të shoqërive përfituese sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e bashkimit ose ndarjes.

Neni 20

Afati i emerimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhen depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 21

Likuidatori eshte i detyruar qe të jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e të drejtave per subjektet ndaj të cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debitore qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 22

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil,Ligjin per QKR, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 23

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Dispozita perfundimtare

Ky statut hartohet dhe nenshkruhet sot me dt.15 Qeshor 2022 ne kater kopje me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe, pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "**IMMOMATUTIS - LEO** " shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet.

Ky statut hyn ne fuqi menjehere pas regjistrimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

ORTAKET E SHOQERISE

Siegfried Matutis



Enkelea Rodhaj

